




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtueshmërisë

**MENAXHIMI I KONTRATËS
“MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I
INFRASTRUKTURËS NË DEPONITË
SANITARE DHE STACIONET E TRANSFERIT
NË KOMPANINË E MENAXHIMIT
TË DEPONIVE NË KOSOVË”**

Prishtinë, mars 2025

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	6
I. HYRJE	8
1. TITULLI DHE SUBJEKTI I AUDITUAR	8
2. PERIUDHA E AUDITUAR	9
3. ARSYETIMI DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT.....	9
4. STANDARDET E AUDITIMIT TË APLIKUARA	9
5. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	9
6. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT.....	10
7. KRITERET E AUDITIMIT	10
II. GJETJET E AUDITIMIT	11
III. REKOMANDIME.....	20
LETËR KONFIRMIMI	21

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000²).

Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet e ndërmarrjes janë në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të pajtueshmërisë për menaxhimin e kontratës "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit në Kompaninë e Menaxhimit të Deponive në Kosovë (KMDK)".

Ekipi që realizoi këtë raport:

Mehmet Muçaj, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Elvir Krasniqi, Udhëheqëse i Ekipit

Fjolla Bakalli Sadiku, Anëtare e Ekipit

Burbuqe Idrizi Ukaj, Anëtare e Ekipit

Kushtrim Leci, Anëtar i Ekipit

1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

2 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e pajtueshmërisë bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

Lista e Shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
RRUOPP	Rregulla dhe Udhëzimi Operativ i Prokurimit Publik
OE	Operatori Ekonomik

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit” në Kompanin për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së)». Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet nëse Kompania ka bërë menaxhimin e kontratës sipas kërkesave të përcaktuara me Rregulla dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të datës 01.02.2021 të KRPP-së dhe Rregulloreve të KMDK-së, për menaxhimin e mbeturinave në deponitë sanitare dhe stacionet e transferit. Kompania me 30.09.2021 kishte lidhur kontratë publike kornizë «Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së me vlerë totale indikative 1,467,753€ për periudhën 3 vjeçare (36 muaj).

Ky auditim përfshinë procesin e menaxhimit të kontratës «Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së» për periudhën Shtator 2021 deri në Qershor 2023 duke u bazuar në pagesat e realizuara. Subjekt i këtij auditimi ishte KMDK me njësitë vartëse të saj.

Konkluzioni i auditimit është se Kompania nuk ka arritur të bëjë menaxhimin e kontratës sipas kërkesave ligjore. Për më shumë, devijimi nga kushtet e kontratës është material për faktin se:

Në tetë (8) pozicione lidhur me menaxhimin e kontratës, sasitë e parashikuara me kontratën kornizë ishin tejkaluar mbi limitin e lejuar ligjor prej 30% ndërkohë që 46 pozicione tjera nuk ishin realizuar fare. Pra, tejkallimet e sasive të kontraktuara për pozicione të caktuara ishin me një kosto shtesë prej 958,189€, mbi pragun e lejuar prej 30%. Tejkallimet sasiore të këtyre pozicioneve ishin prej 60% deri në 3,900%. Vlera e sasive të kontraktuara ishte 304 mijë euro ndërsa vlera e sasive që janë shpenzuar për këto pozicione ishte 1.3 milion euro.

Bazuar në analizat tona konsiderojmë që kontrata kishte ndryshime thelbësore sa i përket sasive. Prandaj, nëse krahasojmë furnizimet e realizuara të kësaj kontrate me çmimet e ofertës së dytë të përgjegjshme të kësaj procedure rezulton që kostot e furnizimeve të tilla do të ishin më të ulëta për 845 mijë euro.

Realizimi i kontratës kornizë për Mirëmbajtjen e Deponive Sanitare dhe Stacioneve të Transferit kishte mungesë të dokumentimit dhe mospërputhje të konsiderueshme midis sasive të faturuara dhe atyre të dokumentuara për zhavorr dhe orët e punës së makinerive. Pjesë të konsiderueshme të punëve dhe furnizimeve të pranuar mungojnë në dokumentacion, duke rezultuar në vlera të faturuara të pajustificuara.

Emërimi i të njëjtit zyrtar si iniciues i procedurës së prokurimit, hartues i paramasës dhe menaxher i kontratës për kontratën kornizë të mirëmbajtjes së deponive sanitare bie në ndesh me parimet e ndarjes së detyrave siç përcaktohen me RRUOPP.

Në 11 raste kemi vërejtur se raportet e pranimit ishin nënshkruar nga personeli i kompanisë mirëpo kompania nuk ka arritur të na ofroj dëshmi se nga kush janë themeluar ato komisione të pranimit. Pra, pagesat janë certifikuar për punë të pranuar nga komisione që nuk janë caktuar me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv.

Për të eliminuar mangësitë e identifikuara, kërkohen veprime konkrete dhe për këtë kemi dhënë katër (4) rekomandime për Menaxhmentin e Kompanisë të cilat i gjeni në kapitullin III rekomandimet.

I. HYRJE

1. TITULLI DHE SUBJEKTI I AUDITUAR

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është person juridik bazuar në ligjin Mbi Ndërmarrjet Publike 03/L-087, ligjin për Shoqëritë Tregtare 06/-016 dhe vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/74, datës 14.07.2009. Si person juridik, Kompania ka aftësinë juridike, ndër të tjera, të zotërojë dhe menaxhojë pronën dhe të lidhë kontrata dhe ti menaxhoj ato kontrata. Kompania ka të drejtë kontraktimi të furnizimeve, punëve apo shërbimeve që i nevojiten kompanisë sipas kornizës ligjore në fuqi.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, organet e kompanisë janë: Aksionarët dhe Kuvendi i Aksionarëve, Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv. Nxjerrja e akteve dhe çfarëdo mase zbatuese brenda fushës së kompetencave të tyre, për ngritjen e vlerës së kompanisë është kompetencë e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv. Kryeshefi ka të drejtë të nxjerrë udhëzime dhe vendime nga fusha e kompetencave të tij. Të gjitha aktet e Bordit të drejtorëve duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Funksionet, rolet dhe përgjegjësitë e kompanisë rregullohen me Statutin e Kompanisë, të miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Proceset e planifikimit, procedurat dhe monitorimi i kontratave zbatohen nga menaxhmenti i kompanisë.

Kompania me 30.09.2021 kishte lidhur kontratë publike kornizë «Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së» me vlerë të parashikuar prej 1,467,753€. Kontrata ishte lidhur për periudhën 3 vjeçare (36 muaj) ndërsa sipas auditimit shpenzimet për këtë kontratë deri më 13.06.2023 ishin 1,717,046€.

2. PERIUDHA E AUDITUAR

Periudha e audituar është 30.09.2021 – 30.09.2023

3. ARSYETIMI DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit ka mandat kushtetues dhe ligjor, për t'i audituar programet dhe projektet e menaxhuara nga organizatat buxhetore apo ndërmarrjet publike dhe të financuara nga buxheti i Kosovës. Auditimi kryhet në bazë të paragrafi 2, nenit 21, të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

4. STANDARDET E AUDITIMIT TË APLIKUARA

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130 Kodin e Etikës,, 400 Parimet e auditimit të pajtueshmërisë, dhe 4000 Standardet e auditimit të pajtueshmërisë dhe manuali i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për dhënien e konkluzioneve të auditimit.

5. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Të përcaktojë shkallën e pajtueshmërisë së vendimeve dhe veprimtarisë së menaxhmentit me kërkesat e kuadrit rregullator përkatës, akteve të brendshme dhe kontratave në fushën e audituar: "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së".

1. Nëse KMDK ka bërë menaxhimin e kontratës "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së", në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përmes këtij auditimi, ne synojmë të japim rekomandime relevante për përmirësimet e mundshme në procesin e menaxhimit të kontratave.

6. FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

6.1. Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi ishte Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh. A me drejtorinë e saj që ishin të involvuara në menaxhimin e kontratës «Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së».

Gjatë këtij auditimi ne nuk kemi pasur ndonjë kufizim që do të ndikonte në punën tonë audituese.

6.2. Përzgjedhja e mostrave të auditimit

Kontrata "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së", që është objekt i auditimit kishte 17 fatura të pranuar dhe të certifikuar, që përbëjnë popullacionin që është objekt auditues. Duke qenë se numri transaksioneve është i vogël, kemi testuar të gjitha këto transaksione. Përveç këtyre faturave të audituara, vlenë të theksohet se një faturë e cila ishte e pa certifikuar nuk është audituar për shkak se lënda ishte në procese gjyqësore.

7. KRITERET E AUDITIMIT

Lista e ligjeve dhe rregulloreve me anë të të cilave rregullohen procedurat dhe menaxhimi i kontratave:

1. Ligji Prokurimi Publik nr. 04/L -042 me plotësim ndryshimet e tij.

Aktet nënligjore:

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik të datë 01.02.2021 të KRPP-së;

Rregullorja nr. 18/2020 për politikën dhe procedurat financiare në KMDK Sh. A;

Rregullore nr. 06/2017 për Menaxhimin e Mbeturinave në Deponitë Sanitare të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë

II. GJETJET E AUDITIMIT

ZKA, në auditimin e kryer ka identifikuar mangësi në procesin e menaxhimit të kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në deponitë sanitare dhe stacionet e transferit të KMDK-së”. Mangësitë e identifikuar pasqyrohen përmes gjetjeve të auditimit të cilat reflektojnë për mënyrën e menaxhimit duke filluar nga ndarja e detyrave dhe menaxhimi i kontratës, mbikëqyrja e respektimit të kushteve të kontratës si dhe arritja e qëllimit. Gjetjet e identifikuar bazohen në analizimin e dokumenteve relevante të pranuar nga kompania, si dhe akterët tjerë relevant të përfshirë në këtë projekt. Në vijim shpalosim mangësitë e identifikuar:

1. Menaxhimi i kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së”

Kriteret: Kriteret e auditimit lidhur me menaxhimin e kontratave të aplikuara për këtë fushë të audituar burojnë nga Ligji Prokurimi Publik nr. 04/L 042 me plotësim ndryshimet e tij dhe Rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik të datë 01.02.2021 të KRPP-së dhe Rregullores 18/2020 për politikat dhe procedurat financiare në KMDK Sh. A.

Bazuar në testimet e kryera kemi identifikuar se

Kontrata “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së” nuk ishte realizuar sipas kushteve të kontraktuar. Kompania me 30.09.2021 kishte lidhur kontratë publike kornizë me vlerë të parashikuar 1,467,753€ mirëpo gjatë procesit të realizimit të kësaj kontratë, auditimi ka identifikuar mangësi të cilat i shpalosim në formë të çështjeve si në vijim:

Çështja 1: Dobësi në realizimin e kontratës - tejkalimi i disa pozicioneve dhe mos shfrytëzimi i pozicioneve tjera

Kriteri: RrUOPP e datës 01.02.2021 përkatësisht neni 56.10 përcakton: “Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe ne rast

të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull”.

Po ashtu neni 61.14 i RrUOPP përcakton se Menaxheri i Projektit do t'i raportojë Departamentit të Prokurimit: (a) çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës; dhe (b) çdo ndryshim në kushtet e kontratës, ose para ose gjatë periudhës së zbatimit, të cilat do të kishin ndikuar në vlerësimin dhe radhitjen e tenderëve dhe në përzgjedhjen e Operatorit ekonomik.

Gjendja: Kemi identifikuar se Kompania gjatë realizimit të kontratës “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së» nuk kishte arritur të realizoj kontratën sipas kushteve të kontraktuara. Pra, nga nënshkrimi i kontratës në shtator të vitit 2021 deri në qershor të vitit 2023, kemi identifikuar që sasitë e kontraktuara ishin tejkaluar dukshëm në tetë (8) pozicione të kontratës. Pra, vlera e sasive të kontraktuara ishte 304 mijë euro ndërsa vlera e sasive që janë shpenzuar ishte 1.3 milion euro. Këto tejkalime janë paraqitur në tabelën në vijim:

Pozicionet	Vlera e kontraktuar	Vlera e shpenzuar	Tejkalimi në vlerë (mbi pragun e lejuar prej 30%)	Përqindja e tejkalimit mbi limitin e lejuar prej 30%
Angazhimin e Kamionit me kontejnerë për bartje të mbeturinave, transportin e mbeturinave prej ST-Ferizaj në drejtim të DS-ve Llog për tonë me të gjitha shpenzimet etj.	3,750€	153,843€	148,968€	3,972%
Angazhimin e Buldozher me zingjirë për shtyerjen dhe trajtimin e mbeturinave. Llog për orë/punë me të gjitha shpenzimet	6,250€	51,437€	43,312€	693%
Furnizimi dhe punimi I pendës arxhinaturës kufizuese me dim. b= 5m dhe h=2.5m, në sektorin e Deponisë Sanitare I cili duhet të zgjerohet nga materiali argjilor rrethor të ngjeshur I cili është I pa përshkueshëm nga uji I cili sherben për krijimin e një zone të sigurt për deponimin e mbeturinave dhe mbrojnë zonën perimetrike përreth DS nga kontaminimi.	70,000€	519,544€	428,544€	612%
Furnizimi me sasi dheu për mbulimin e mbeturinave me të gjitha shpenzimet ngarkimin, si dhe transportin prej pikës marrëse deri në lokacionin e mbulimit të sektorit.	70,000€	263,336€	172,336€	246%

Angazhimi e eskavatorit për hapjen e kanaleve si dhe ndërprerjen e ujërave të cilët rrjedhin në infrastrukturën rrugore. Llog për orë/pune me të gjitha shpenzimet etj.	8,000€	25,464€	15,064€	188%
Angazhimin e Kamion kipper për transportimin e materialit ndërtimor të nevojshëm për rregullimin e infrastrukturës rrugore brenda deponisë. Llog për m3 me të gjitha shpenzimet etj.	80,000€	200,340€	96,340€	120%
Angazhimin e makinerisë për ngarkimin dhe shtyerjen e mbeturinave. Llog për orë/pune me të gjitha shpenzimet	34,500€	77,108€	32,258€	94%
Angazhimi e eskavatorit për trajtimin e mbeturrinës, rregullimin skarpateve dhe infrastrukturës në Deponi Sanitare. Llog për orë/pune me të gjitha shpenzimet etj	31,500€	62,317€	21,367€	68%
GJITHSEJ VLERA E TEJKALUAR	304,000€	1,353,389€	958,189€	

Përveç tejkalimeve të sasive kontraktuara kemi vërejtur se KMDK në 46 pozicione të kësaj kontrate nuk ishte realizuar asnjë shpenzim.

Bazuar në analizat tona konsiderojmë që kontrata kishte ndryshim thelbësor sa i përket sasive. Prandaj, nëse krahasojmë furnizimet e realizuara të kësaj kontrate me çmimet e ofertës së dytë të përgjegjshme të kësaj procedure rezulton që kostot e furnizimeve të tilla do të ishin më të ulëta për 845,475€.

Shkaku: Shkaku i tejkalimit të sasive të kontraktuara ishte planifikimi jo i duhur i sasive të parashikuara dhe mbikëqyrjes së dobët gjatë procesit të realizimit të kontratës. Ndërsa mos shfrytëzimi i disa pozicioneve të kontraktuara është si rezultat i mungesës së analizave të mirëfillta gjatë procesit të hartimit të paramasës në raport me nevojat reale për shërbime.

Rreziku: Planifikimi jo i mirë ka ndikuar që KMDK të lidhë kontratë jo ekonomike duke mos arritur vlerën për parane e shpenzuar. Për më shumë, tejkalimi i sasive mund të ndikoj që entiteti të bëjë shpenzime të panevojshme dhe rritë mundësinë për manipulime me sasi apo shërbime të pranuar.

REKOMANDIMI

Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që sistemi i kontrollit funksionon dhe arrin të parandaloj devijimet në kohë, si dhe të sigurojë që menaxherët e projekteve të ndjekin rregullisht procedurat për të raportuar çdo ndryshim në kushte dhe sasi tek Departamenti i Prokurimit. Po ashtu, duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që proceset e vlerësimit të nevojave të bëhet më me saktësi me qëllim që sasitë e parashikuara në kontrata të realizohen dhe të arrihen objektivat e caktuara.

Çështja 2 Mungesë e dokumentimit të punëve dhe furnizimeve të kryera në Deponitë Sanitare dhe Stacionin e Transferit

Kriteri Neni 29 përkatësisht paragrafi 2 i Rregullores nr. 18/2020 për Politikën dhe Procedurat Financiare në KMDK Sh. A parasheh: Çdo hyrje/dalje e mallit në depot e Kompanisë bëhet sipas rregullave të përshkruara duke përfshirë procedurën e porosisë (fletë deponimi/fletë dërgesë), çmimin e artikullit, sasinë, llojin/nën-llojin e artikullit, dimensionet/karakteristikat e ambalazhit, peshën apo njësinë tjetër matëse etj.

Neni 39 përkatësisht paragrafi 2 parasheh: Verifikimi dhe certifikimi i faturave, kontratave bëhet nga Zyrtari Certifikues para se ajo të lejohet për pagesë/ekzekutim. Certifikimi i një fature lidhur me furnizime, shërbime dhe punë duhet të përmbajë ndër të tjera edhe fletë dërgesën e nënshkruar nga pranuesi i furnizimeve dhe mallrave (pika 5 e paragrafit 2) si dhe për shërbime dhe punë, situacioni i punimeve i bashkangjitur në libër dhe ditar ndërtimor (pika 6 e paragrafit 2).

Neni 15.2 i Rregullores nr. 06/2017 për Menaxhimin e mbeturinave në deponitë sanitare të kompanisë për menaxhimin e deponive në Kosovë, përcakton që hyrja e personave dhe automjeteve për periudhën e kryerjes së punimeve investuese, sanuese apo të rehabilitimit të deponisë duhet të dokumentohet me shënime të hyrje daljeve dhe të evidentohen në librin e regjistrit /softuer.

Gjendja: Për kontratën kornizë “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së» ishin faturuar gjithsej 17 fatura për furnizime dhe shërbime të pranuar në vlerë 1,717,047€. Nga analizimi i dokumenteve mbështetëse si ditarin ndërtimor, fletë dërgesat e pranuar si dhe ditarëve të punës së deponive, kemi identifikuar se kishte mos përputhje lidhur me sasinë e furnizuara, si dhe mungesë të dokumentimit lidhur me punët dhe furnizimet e pranuar/faturuara. Këto mospërputhje janë paraqitur si më poshtë:

- Në pozicionet “Furnizime me zhavorr” kemi vërejtur se ishin faturuar dhe certifikuar për pagesë 12,752 m³ zhavorr në vlerë prej 210,408€. Sipas dokumenteve mbështetëse si fletë dërgesat për furnizim me zhavorr, ishin pranuar gjithsej 6,116 m³ në vlerë 100,914€ ndërsa sipas evidencave të brendshme dhe regjistrimeve ditore në ditarët e deponive kemi siguruar dëshmi vetëm për 3,282 m³ apo në vlerë rreth 54,153€.

Tutje, kemi analizuar nëse kjo sasi e pranuar sipas fletë dërgesave si dhe ditarëve të deponive është evidentuar edhe në librin ndërtimor të OE (i aprovuar po ashtu nga Menaxheri i Kontratës) dhe kemi identifikuar se në librin ndërtimor të OE janë evidentuar vetëm 3,214m³.

Duke u bazuar në dokumentet në dispozicion, për sasinë 6,636 m³ në vlerë 109,494€ të faturuar për furnizim me zhavorr, kompania nuk ka ofruar fare evidenca të furnizimit rrjedhimisht mungojnë fletë dërgesat si dhe evidentimet në ditarët e deponive dhe librin ndërtimor të OE.

Sa i përket angazhimit të makinerive, kemi identifikuar mospërputhshmëri në mes vlerës së faturuar për orë pune në raport me fletë dërgesat për punët e pranuar. Këto diferenca janë paraqitur si më poshtë:

- Për angazhimin e makinerisë për ngarkimin dhe shtyrjen e mbeturinave vlera e faturuar për 671 orë pune ishte 77,108€ ndërsa sipas fletë dërgesave janë të dokumentuara vetëm 114 orë pune në vlerë 13,110€. Rrjedhimisht, kompania nuk ka arritur të ofroj dëshmi të dokumentimit për punë të pranuar në vlerë 63,998€. Tutje, sipas ditarit të regjistrimeve të punës ditore në deponi, kemi identifikuar se 77 orë pune në vlerë 8,855€ ishin faturuar për angazhimin e makinerisë për ngarkimin e mbeturinave në Stacionin e Transferit (ST) Ferizaj, ndërsa kemi vërejtur se sipas ditarëve të deponisë ngarkimi i mbeturinave ishte bërë nga makineria e KMDK-së dhe jo nga operatori ekonomik.
- Për angazhimin e nivelizuesit (Grejder) për nivelizimin apo rrafshimin e rrugëve brenda deponive për ngarkim, vlera e faturuar për 262 orë pune ishte 7,860€ ndërsa sipas fletë dërgesave janë të dokumentuara vetëm 33 orë pune në vlerë 990€. Prandaj, për 229 orë pune të faturuara në vlerë 6,870€ kompania nuk kishte dokumente mbështetëse.
- Për angazhimin e cilindrit vribruës për ngjeshjen e infrastrukturës rrugore, vlera e faturuar për 174 orë pune ishte 6,090€ ndërsa në dokumentet e ofruara mbështetëse nga KMDK si fletë dërgesat dhe ditarët e deponive nuk ka evidenca për angazhim të një pajisje të tillë

Për furnizimin me sasi dheu/argjilë sipas kontratës parashihen edhe këto pozicione:

Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia e faturuar	çmimi njësi me TVSH	Total
Furnizimi me sasi dheu për mbulimin e mbeturinave me të gjitha shpenzimet ngarkimin, si dhe transportin prej pikës marrëse deri në lokacioni e mbulimit të sektorit	m ³	75,239.00	3.5	263,336.50
Angazhimin e Kamion kipper për transportimin e materialit ndërtimor të nevojshëm për rregullimin e infrastrukturës rrugore brenda deponisë. Llog për m3 me të gjitha shpenzimet etj	m ³	50,085.00	4	200,340.00
Furnizimi dhe punimi i pendës arxhinaturës kufizuese me dim. b= 5m dhe h=2.5m, në sektorin e Deponisë Sanitare i cili duhet të zgjerohet nga materiali argjilor rrethor të ngjeshur i cili është i pa përshkueshëm nga uji i cili shërben për krijimin e një zone të sigurt për deponimin e mbeturinave dhe mbrojnë zonën perimetrike përreth DS nga kontaminimi.	m ³	74,220.50	7	519,543.50
Gjithsej faturimi	m ³	199,544.50		983,220.00

Duke ju referuar tabelës më lart, janë të faturuara gjithsej 199,544.50 m³ furnizim të dheut dhe argjilës në vlerë 983,220€ (për tri pozicionet e kontratës), ndërsa sipas dokumenteve në dispozicion (fletë dërgesa) janë gjithsej 211,240 m³ sasi të dheut/argjilës të pranuar me fletë dërgesa. Prej tyre, rreth 70 mijë kubik (m³) janë të evidentuara në ditarët e deponive. Vlen të theksohet se në ditarët e deponive nuk ka raport të detajuar lidhur me destinimin e dheut të pranuar përkatësisht sasinë që është shfrytëzuar për mbulim të mbeturinave, punim të pendës së argjinaturës apo për ndonjë qëllim tjetër. Rrjedhimisht mungesa e këtij informacioni e pamundëson vlerësimin e saktësisë së sasive së faturuara të dheut/argjilës në pozicionet përkatëse të kontratës.

Sipas ekzaminimit fizik gjatë vizitës në muajin gusht 2024 në deponinë e Landovicës, kemi vërejtur se një kamion me dhe/argjilë nga pika e ngarkimit deri në zbrazje dhe kthim në pikën e ngarkimit i duhej një kohë minimale prej 15 minuta.

Në disa raste në fletë dërgesa kemi vërejtur se furnizimi me sasi të dheut ishte më e madhe se sa kapaciteti i makinerive të angazhuara në ato ditë.

Në një rast sipas fletë dërgesës nr. 294 kemi vërejtur se pesë (5) kamiona me kapacitet prej 18 m³ brenda 8 orëve kishin bërë furnizimin me 5,580 m³ dhe/argjilë, që i bie se për 7 minuta secili kamion ishte ngarkuar me dhe/argjilë, kishte bërë transportin deri në piken e zbrazjes dhe ishte kthyer papë për mbushje, gjë që praktikisht është e pamundur.

Sa i përket pozicioneve të "Furnizimit dhe vendosjes së gypave/pusetave" kemi identifikuar se ishin faturuar 1,439m në vlerë 44,390€ ndërsa sipas evidencave të fletë dërgesave dhe regjistrimeve në ditarët e deponive ekzistojnë vetëm për 591m furnizim.. Rrjedhimisht për 848m furnizim kompania nuk ka arritur të ofroj dokumente mbështetëse.

Bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit konsiderojmë se kishte devijime/mangësi të theksuara gjatë procesit të realizimit të kësaj kontrate. Kjo pa mundëson një vlerësim të qëndrueshëm nëse furnizimet apo punët janë pranuar me të vërtetë në përputhje me vlerën e faturuar dhe të certifikuar për pagesë.

Shkaku: Shkak i devijimit të kontratës nga kushtet e kontraktuara ishin se Kompania nuk kishte sistemin e kontrollit të brendshëm efektiv për të parandaluar dobësitë e tilla.

Rreziku: Mungesa e kontrolleve të brendshme dhe llogaridhënia e dobët në menaxhimin e kësaj kontrate ka ndikuar që të ketë mos përputhje në mes të regjistrave të brendshme (fletë dërgesave dhe evidencave të deponive dhe faturimeve) dhe mungesë të dokumentimit përkatës.

REKOMANDIMI

Bordi i Drejtorëve duhet të forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të gjitha punët dhe furnizimet të dokumentohen në mënyrë të detajuar sipas kërkesave kontraktuale. Po ashtu, Boardi duhet të vendos një proces të qartë për mbajtjen e ditarëve të punës dhe librave të ndërtimit, ku të evidentohen saktësisht të gjitha furnizimet dhe shërbimet e kryera si dhe të siguroj se para çdo pagesë të verifikohet dokumentacioni mbështetës si fletë dërgesat, regjistrimet ditore.

Çështja 3: Ndarje jo e duhur e detyrave në procesin e menaxhimit të kontratës

Kriteri Bazuar në nenin 62.1, Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik të datës 01.02.2021 të KRPP-së, «Ndarja e detyrave» do të thotë se autoriteti i një personi (ave) për të miratuar dhe për të nënshkruar miratimin në një fushë të përgjegjësisë nuk përfshinë edhe ato të një tjetër fushe të përgjegjësisë. Disiplinat e specializuara të përgatitjes së kontratave (ligjore dhe teknike), zbatimit të kontratës dhe pagesave (faturat) duhet të mbahen si aktivitete të veçanta me miratimet e veçanta nënshkruese. Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Prokurimit dhe Njësia pranuese / Menaxheri i projektit nuk mund të nënshkruajnë ndonjë dokumentacion jashtë fushës së tyre të përgjegjësisë.

Kurse sipas 62.3 Parimet e ndarjes së detyrave i japin autoritet vetëm personave të mëposhtëm (ose zëvendësi / ndihmësi i caktuar i atij departamenti) në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave që bëhet në emër të autoritetit kontraktues. Po ashtu paragrafi 4 i nenit 62.3 përcakton se Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose TER, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura, nuk mund të nënshkruajë për asnjë nga artikujt 1 ose 2 që ndërlidhën me pranimin e mallrave, artikujve të instaluar, punët në përfundimin e një projekti, dorëzimin në fazë, dhe as nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit.

Gjendja: Te kontrata kornizë “Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së” e nënshkruar në shtator të vitit 2021 në vlerë indikative prej 1,467,753€, kemi identifikuar se zyrtari i cili ishte iniciues i procedurës së prokurimit dhe hartues i paramasës/parallogarisë së kontratës ishte caktuar edhe si menaxher i kontratës. Pra, kjo ishte në kundërshtim me nenin 62.3 parimet e ndarjes së detyrave.

Shkaku: Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte vendosur kontrole adekuate tek ndarja e detyrave sipas kërkesave ligjore.

Rreziku: Mos ndarja e duhur e detyrave përveç që është e kundërshtim me kërkesat ligjore mund të dëmtojë reputacionin e kompanisë, cenojë integritetin e procesit të realizimit të kontratës. Kështu që një mangësi e tillë mund të ndikojë negativisht në menaxhimin e kontratave, duke çuar në devijime të kontratës dhe në përmbushjen e detyrimeve dhe në mosrealizimin e standardeve të pritura për cilësinë e shërbimeve ose punëve të kryera.

REKOMANDIMI

Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që jenë vendosur kontrolle adekuate dhe monitorimin e ndarjes së detyrave sipas kërkesave ligjore duke qartësuar rolin e çdo zyrtari.

Çështja 4: Pranimi i punëve nga personeli i deponisë por jo të caktuar me vendim nga Kryeshefit Ekzekutiv

Kriteri: Sipas nenit 39 paragrafi 2 i Rregullores 18/2020 për politikat dhe procedurat financiare në KMDK Sh. A., Verifikimi dhe certifikimi i faturave, kontratave bëhet nga Zyrtari Certifikues paraprakisht se ajo të lejohet për pagesë/ekzekutiv. Certifikimi i një fature lidhur me furnizime, shërbime dhe punë duhet të përmbaj ndër të tjera "Raportin e menaxherit të kontratës ose raporti i pranimit nga ana e komisionit i themeluar me vendim të veçantë të Kryeshefit ekzekutiv (KE). Ndërsa sipas vendimit të Kryeshefit të KMDK-së Nr. 59/2017 ndër tjerash kërkohet që për pranimin e mallit të formohen komisione ad hoc për secilin rast konkret.

Gjendja: Në 11 raste kemi vërejtur se pagesat janë certifikuar për punë të pranuar duke u bazuar në raporte të pranimit të cilat ishin nënshkruar nga personeli i deponisë për të cilët nuk kishte vendim të shkruar. Ne kemi kërkuar nga kompania që të na sigurohen vendimet e komisioneve të pranimit, mirëpo nuk kemi pranuar vendimet e tilla. Pra, nuk na janë ofruar dëshmi se nga kush janë autorizuar personeli që ka nënshkruar raportet e pranimit.

Shkaku: Sistemi i dobët i kontrollit të brendshëm ka ndikuar që të certifikohen punë/shërbime përmes personelit të deponisë por pa vendime përkatëse.

Rreziku: Në rastet kur punët pranohen nga personeli i deponisë pa ndonjë vendim të autorizuar nga Kryeshefi ekzekutiv, rritë rrezikun që punët/shërbimet të mos jenë sipas kriterëve të kërkuara, si dhe rritë mundësinë për gabime. Pranimi dhe certifikimi i punëve pa përfshirjen e një komisioni të caktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv tregon për një dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm.

REKOMANDIMI

Kryeshefi ekzekutiv të sigurojë që verifikimi dhe certifikimi i të gjitha punëve të kryhen nga komisione të caktuara me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KONKLuzionET

Bazuar në gjetjet e auditimit konkludojmë se Kompania nuk kishte menaxhuar kontratën sipas kërkesave ligjore për menaxhimin e kontratës.

Tejkalimet e theksuara të sasive të kontraktuara në tetë (8) pozicione të kontratës, me një kosto shtesë prej 958,189€, kanë bërë që kontrata të tejkalojë pragun e lejuar prej 30%, ndërkohë që 46 pozicione të tjera nuk janë realizuar fare. Bazuar në analizat tona konsiderojmë që kontrata kishte ndryshim thelbësor sa i përket sasive. Prandaj, nëse krahasojmë furnizimet e realizuara të kësaj kontrate me çmimet e ofertës së dytë të përgjegjshme të kësaj procedure rezulton që kostot e furnizimeve të tilla do të ishin më të ulëta për 845,475€.

Realizimi i kontratës kornizë për Mirëmbajtjen e Deponive Sanitare dhe Stacioneve të Transferit kishte mungesë të dokumentimit dhe mospërputhje të konsiderueshme midis sasive të faturuara dhe atyre të dokumentuara për zhavorr dhe orët e punës së makinerive. Pjesë të konsiderueshme të punëve dhe furnizimeve të pranuar mungojnë në dokumentacion, duke rezultuar në vlera të faturuara të pajustificuara.

Emërimi i të njëjtit zyrtar si iniciues i procedurës së prokurimit, hartues i paramasës dhe menaxher i kontratës për kontratën kornizë të mirëmbajtjes së deponive sanitare ishte në kundërshtim me parimet e ndarjes së detyrave siç përcaktohej me kornizën ligjore të aplikueshme në atë kohë.

Në 11 raste kemi vërejtur se raportet e pranimit ishin nënshkruar nga personeli i kompanisë mirëpo kompania nuk ka arritur të na ofroj dëshmi se nga kush janë themeluar ato komisione të pranimit. Pra, pagesat janë certifikuar për punë të pranuar nga komisione që nuk janë caktuar me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv.

III. REKOMANDIME

Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit ekzekutiv të kompanisë i janë dhënë rekomandimet e mëposhtme:

1. Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj që sistemi i kontrollit funksionon dhe arrin të parandaloj devijimet në kohë, si dhe të sigurojë që menaxherët e projekteve të ndjekin rregullisht procedurat për të raportuar çdo ndryshim në kushte dhe sasi tek Departamenti i Prokurimit. Po ashtu, duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që proceset e vlerësimit të nevojave të bëhet më me saktësi me qëllim që sasisë e parashikuara në kontrata të realizohen dhe të arrihen objektivat e caktuara. Kryeshefi ekzekutiv duhet të përmirësojë monitorimin e kontratave për të siguruar përputhjen me kufizimet e sasisë indikative dhe pragun e lejuar prej $\pm 30\%$.
2. Bordi i Drejtorëve duhet të forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të gjitha punët dhe furnizimet të dokumentohen në mënyrë të detajuar sipas kërkesave kontraktuale. Po ashtu, Kryeshefi ekzekutiv duhet të vendos një proces të qartë për mbajtjen e ditarëve të punës dhe librave të ndërtimit, ku të evidentohen saktësisht të gjitha furnizimet dhe shërbimet e kryera si dhe të siguroj se para çdo pagesë të verifikohet dokumentacioni mbështetës si fletë dërgesat, regjistrimet ditore.
3. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që jenë vendosur kontrole adekuate dhe monitorimin e ndarjes së detyrave sipas kërkesave ligjore duke qartësuar rolin e çdo zyrtari.
4. Kryeshefi ekzekutiv duhet të sigurojë procedura të qarta lidhur me pranimin e punëve/shërbimeve në mënyrë që verifikimi dhe certifikimi i të gjitha punëve të bëhen nga komisione të themeluara me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

LETËR KONFIRMIMI



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin menaxhimit të kontratës "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së" për periudhën 2021 - 2023

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin kontratës "Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në Deponitë Sanitare dhe Stacionet e Transferit të KMDK-së" për periudhën 2021 - 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Afrim Kenjufca

Kryesues i Bordit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë ,

Data: 24 Janar 2025





Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës